REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 30.09.2025 Prot.44 (dyzetëekatër)

Protokoll nr. 44

I mbajtur sot më datë 30.09.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 26.08.2025.
4. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin shtator 2025";
5. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
6.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Y.K banues në fshatin Pojan NJ.A Pojan, banesat e të cilit u dogjën si shkak i rënies të zjarrit";
7.P-V "Për rishpërndarjen e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin 2025'' ;
8.P-V "Për detajimin e fondeve për shpenzime kapitale'';
9.P-V "Për miratimin e Raportit të II-të të Monitorimit për 8-mujorin e vitit 2025";
10.P-V"Për ngritjen e grupit të punës për procesin e hartimit të Planit të Integriteti në Bashkinë Maliq";
11. Zgjedhja e përfaqësuesit të Këshillit Bashkiak Maliq në Këshillin e Qarkut Korçë pas vakancës të krijuar.
12. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Dritan Çami; Idlir Limllari; Eriseld Jonusllari; Kristina Malelli; Fevri Sherifi; Danjela Ibrahim; Marinathi Avrami; Enida Avdolli; Klea Baçi; Floreta Zaçe; Pranvera Begolli; Faslli Zholi; Eglantina Balli; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Neresida Shindo; Server Xhuti; Dalina Krekas; 21 (njëzetëenjë) këshilltarë

Mungesa: Xhuana Hoxhallari; Aramando Dautllari; Rovena Terolli; Ilia Xhuti; Plator Çollaku; Marjeta Xhelollari; Andonaq Risto; Almir Elezi; Albina Xhejo; 9 (nëntë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Sekretare e Përgjithshme; znj.Jonila Xhihalli, Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka; Përgjegjësi i Audit të Brendshëm; z.Afrim Beqiraj; Drejtori i Pronave Publike dhe Aseteve:z.Johand Sula; Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti; Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta;

Ornildi Demollari: Mirë fillojmë. Përshëndetje të gjithëve të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës. Fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë, sikurse jeni njoftuar. Fillimisht, verifikojmë korumin, i cili realizohet pasi janë. Tetëmbëdhjetë këshilltarë në sallë,(20), kështu që mund të vijojmë. Me materialet e mbledhjes që ju jeni njohur dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës. Kush është dakord me rendin e ditës? Kundër, nuk ka abstenim, nuk ka miratohet rendi i ditës. Faleminderit. Më lejoni t'ju kujtoj konfliktin e interesit të nderuar kolegë. Nëse ndonjëri nga ne, nga ju, ka konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës, është mirë që në atë pikë të mos përfshihet as në diskutim, as në votim është e mirë, faleminderit. Të më lejoni ndërkohë t'ju njoh me vendimet, me projektvendimet e mbledhjes së kaluar, të cilat janë kthyer në vendime, pasi kanë marrë edhe dakordësinë e institucionit të prefekturës. Disa prej tyre konkretisht ato që janë me karakter normativ dhe janë tetë vendime me karakter normativ dhe katër me karakter kolektiv, të cilat janë kthyer në vendime tashmë. Ju ftoj të miratojnë procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Kush është dakord me procesverbalin e mbledhjes? Kundër nuk ka abstenim, nuk ka miratohet procesverbali i mbledhjes. Faleminderit, shkojmë tani tek pika katër e rendit të ditës. Projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin gusht dy mijë e njëzet e pesë. Nuk ju thashë nga ekzekutivi, mbledhjen po e shoqëron sekretarja e përgjithshme, zonja Jonila. Ndërkohë që janë edhe drejtuesit e. institucioneve të bashkisë, të cilët janë përgjegjës për materialet e përfshira në rendin e ditës, siç është Drejtoresha e Financës, Përgjegjësi i Auditit, Drejtoresha e Shërbimit Social. Tek katra, tek ndihma ekonomike, kemi ndonjë koment, ndonjë pyetje?Po.

Faslli Zholi:Përshëndetje, faleminderit të gjithëve. Në dije, lodha erdha në u paraqita në komisionin e. Sipas rregullores të pikës katër dhe pesë, prapë e kam ngritur disa herë. Komisionet nuk funksionojnë. Unë me sekretarin e këshillit ishim. Do thotë dikush që ndihmat ekonomike janë, po mirë është, komisionet e kemi thënë disa herë duhet që të jenë funksionale. Prandaj kam vërejtje për të gjithë ata pjesëtarë që unë drejtoja këtë komision. Nuk ishte asnjë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit t'i bashkohem komentit të nënkryetarit. Ju lutem të jeni më të përgjegjshëm dhe më të disponueshëm në mbledhjet e komisioneve. Për të gjithë, jo vetëm për kemi gjë tek ndihma ekonomike. E kalojmë votim?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Faleminderit.Kalojmë tek pika pesë e rendit të ditës, projektvendim për dhënien ndihmë financiare për familjet nevojë.Janë disa familje.Po

Faslli Zholi:Këtu dua të shtoj, i pashë atë ishte e cekët, ka nevojë materiali për të bërë më i kompletuar. Sepse unë jam plotësisht dakord me një familje që edhe e njoh, nga Sovjani, që fatkeqësisht s'ka as bashkëshort. Të marrin ndihmën ekonomike, të vijnë në ndihmë, po të ketë disa argumenta se dikush e njeh, dikush ishte materiali jo i plotë. Faleminderit.
Ornildi Demollari: Për relacionin e ke fjalën?

Faslli Zholi: Po.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhihalli:Përshëndetje të gjithëve, këtu kemi drejtoreshën e shërbimit social, e cila mund të japë më detaje për secilën familje, se si i kanë pranuar, pasi ata janë dhe më në dijeni.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti:Përshëndetje, faleminderit përsa i përket relacionit. Atëherë do të do të sigurohemi që relacioni të vijë me plot dhe t'i paraqitet këshillit. Por do të kërkoja të të respektojmë edhe parimin e konfidencialitetit, duke qënë se në qoftë se ne shpalosim në në këshillë, informacione më të detajuar në lidhje me kushtet sociale-ekonomike të familjes biem ndesh edhe me parimin e konfidencialitetit për të ruajtur privatësinë e të dhënave që familja ka. Në qoftë se ju jeni, ka diçka që duhet ta diskutojmë, patjetër do t'ju paraqisim edhe dokumenta të cilat ne i shoqërojmë bashkëngjitur vendimit dhe drejtoria e financës bën kalimin në thesar, të cilët këto dokumenta pasqyrojnë edhe gjendjen ekonomike të familjes. Prandaj është ndoshta pak.

Faslli Zholi: Do shtoja dhe diçka, unë e di, dhe nuk dua ta bëj tellallin këtë histori, se ata janë nevojtarë, kuptohet, janë hallexhinj mbi të gjitha, dhe jam katërcipërisht për këtë histori. Nuk po flas me detaje emrat, po dua që materiali, ka këshilltarë që nuk e di se kush është kjo zonja, apo kush është kjo që është djegur shtëpia, apo kush është ajo që ka këtë hall. Mej llaf të shkruhen. Ato parametra që ne na i lejon baza ligjore në këshillin.

Drejtore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti: Patjetër, atëherë propozimet do vijnë më të zgjeruara, patjetër.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi gjë këtu tek pika pesë. Janë disa familje të cilat, u është akorduar nga një ndihmë simbolike, ndihmë ekonomike. E kalojnë votimet atëhere?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Faleminderit.Duke shpresuar që t'u vijmë sado pak në ndihmë. Kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, projekt vendim për dhënie ndihmë financiare për familjen e Zotit me inicialet Y.K banues në fshatin Pojan, njësi administrative Pojan, banesa e të cilit u dogj si shkak i rënies së zjarrit. Po, Fevri.

Fevri Sherifi: Atij t'i jepet ndihma financiare, sepse t'i jepet ajo që është për të dhënë, se u dogj në fakt. Ajo është një njeri mallexhi, pa grua.

Ornildi Demollari: Kemi ndonjë pyetje tjetër, ndonjë koment? Po.

Yllson Ibrahimllari:I nderuar kryetar, të nderuar kolegë, e nderuar përfaqësuese e ekzekutivit. Jemi njohur prej, drejtorisë së emergjencave civile dhe me një rast rënie zjarri në fshatin Strelc, të cilën unë e kam diskutuar me sekretarin e këshillit. Ndërkohë, edhe nga emergjencat civile, besoj duhet të kishte ardhur një raport për këtë familje dhe cila ishte mundësia. Për t'u përfshirë dhe ajo në përfitimet e mundshme të një ndihme, ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Stilian, do ulesh në në një vend, në një karrige me mikrofon, të lutem.

Përgjegjësi i Sektorit të Emergjencave Civile:z.Stiljan Belishta: Përshëndetje të gjithëve, përshëndetjeve. Atëherësh po e nisim lidhur me shqetësimin që ngriti i nderuar zoti këshilltar. Më konkretisht, duke qenë se unë kam dhe njohje personale me doktorin, qëndron dhe është me vend nga ana e sektorit të emergjencave civile, me një urdhër të kryetarit të bashkisë është ngritur grupi i punës për vlerësimin e dëmeve dhe aktualisht është përfunduar vlerësimi i dëmeve për këtë familje, por për shkak të procedurave që përcakton ligjin njëqind e dyzet e pesë dy mijë e nëntëmbëdhjetë për mbrojtjen civileve, nuk duhet të respektojmë afatet kohore, që do të thotë. Janë pesë ditë afati nga ngritja e grupit të punës, pra grupi i konstatimit, dhe pesëmbëdhjetë ditë ose afërsisht dy javë që është afati për vlerësimin e dëmeve, kështu që ishte e pamundur. Neve kemi mbyllur vlerësimin, por për të respektuar procedurat, duhet të presim që ky rast të kalojë për miratim dhe për dhënie të ndihmës financiare familjes së dëmtuara në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Bashkisë.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Ka ndonjë gjë tjetër? E kalojmë votim, atëherë?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Miratohet pika gjashtë. Faleminderit, kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës. Projektvendim për rishpërndarjen e buxhetit shtesë të Bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzet e pesë. Joni, zonja sekretar, po komisioni, po më fal. Petrit, po më fal.

Petrit Kupe:Në këtë përshëndetje të gjithëve, në këtë projektvendim bëhet fjalë për një shpërndarje të një fondi. I cili është parashikuar në buxhetin e vitit dy mijë e njëzet e pesë për përballime të TVSH, për blerjen e një mini fadrome nga të dhuruar nga Ambasada Japoneze, por ndërkohë Bashkia ka aplikuar pranë Ministrisë së Financave dhe ky fond domethënë nuk përdoret për të përballuar këtë TVSH, kështu që ky ngelet i lirë dhe mendohet të pakësohet ky zë dhe të kalojë ky fund për rikonstruksion lapidarin në fshatin Rrëmbec. Ne jemi dakord, besoj se është një gjë e mirë, është një nga lapidarët më të rëndësishme në territorin e bashkisë, jemi dakord që të miratohet.

Ornildi Demollari: Po, faleminderit, drejtoreshë.Kemi ndonjë pyetje tjetër këtu, përveç shpjegimit nga komisioni? Lapidari është një kërkesë e vazhdueshme e banorëve atje, kështu që le të kalojë.
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Faleminderit.Kalojmë tek pika tetë e rendit të ditës, projektvendim për detajimin e fondeve për shpenzime kapitale, komisioni.Tek pika tetë.

Petrit Kupe: Kjo është një përdorim fondi nga të ardhurat për të përdorur për një projekt ndërtimi ushqyes veprave ujore. Një fund për projektin, megjithatë në qoftë se mundet. Mundet të përcaktohet ç'janë këto vepra ujore, se duket si një fjalë kështu e përgjigjshme, por konkretisht, jo se jemi kundër, por duhet të dimë ku do të përdoret mendimi tonë.

Ornildi Demollari: Drejtoreshë, do më shpjegoni diçka ju apo sekretarja? Po, po.

Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka:Përshëndetje nga Ambasada Bullgare, vitin e kaluar na ka erdhur një fond, i cili u përdor për blerjen e një mjeti të. Po e shpjegoj nga fillimi mjetin për transportin e fëmijëve me aftësi ndryshe, të cilët për në qendrën komunitare që është afër në Bashkinë Maliq. Ne e likuiduam fondin dhe të vësheja sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave numër dhjetë. Do t'i kthej dhe bëmë aplikim në SASPAKU dhe u kthye në vlerën treqind e pesëdhjetë e shtatë mijë lekë TVSH-ja e këtij mjeti. Tani nga Ministria e Financave u çel një fond i cili është çelur në kapitullin gjashtëqind e katër dhe ne duhet ta rishpërndajmë këtë fond për shpenzim për investime. Duke e menduar bashkë me kryetarin dhe me bordin e kullimit, menduan që këto fonde të harxhojnë për projekt. Projekt ndërtim vepra ujore, ushqyes vepra ujore. Dhe kjo është për ushqyesin e rezervuarve. Tani të përcaktohet ku do të bëhet ky projekt. Se nuk e bëjnë dot me forcat e bashkisë dhe menduan që të hidhet për tenderim dhe kush ta fitojë të bëjë rezervuari ushqyesi. Që është në territorin e bashkisë, ky ishte shpjegimi.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi ndonjë pyetje? E kalojmë votim atëherë pikën tetë?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me 21 vota pro.Faleminderit.Kalojmë tek pika nëntë e rendit të ditës, projektvendim për miratimin e raportit të dytë të monitorimit për tetë mujorin e vitit dy mijë e njëzet e pesë, raportin e dytë të monitorimit. Ka ndonjë pyetje? Komisioni i financës.

Petrit Kupe: Jo, nuk kemi ndonjë pyetje. Është një raport periodik që kryhet nga drejtori i financës. Ku vlerësohen treguesit e planifikuar me ata të realizuar për periudhën tetë mujore. Ajo që bie në sy në këtë raport, megjithëse është goxha voluminoz, është i njëjti problem që kemi konstatuar edhe në raportet e tjera. Dhe kontradita e realizimit të të ardhurave në krahasim me

shpenzimet që realizohen në mbi 90%. Të ardhurat janë në ato nivele 45-50% të parashikuara. Ndoshta mendojmë ne që kjo është ndonjë defekt i planifikimit, sepse në këto vite të ardhurat pothuajse realizohen 50-55%. Kështu që mendojmë se është një plan shumë i paargumentuar dhe e nxjerr të paralizuar këtë tregues. Ajo që vlerësojmë ne është që të ardhurat, pavarësisht nga përqindja e realizimit kundrejt planit, kanë një rritje graduale nga viti në vit. E cila vlerëson, tregon dhe punën që bëhet nga drejtoria e të ardhurave. Megjithatë, përsëri është një nga burimet kryesore të rezervës të sigurimit të tarëve për investime të tjera. Këtu, ky është një nga problemet e raportit. Me të tjerat jemi dakord,

Ornildi Demollari: Drejtoreshë tek realizimi.

Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka: Tani, në bazë të ligjit gjashtëdhjetë e tetë, dy mijë e shtatëmbëdhjetë, për financat e qeverisjes vendore, neni dyzetë e tetë. monitorimi dhe zbatimi i buxhetit në pushtetin vendor dhe udhëzimi të Ministrisë së Financave, numër njëzet e dy. Në çdo katër mujor bëhet një raport monitorimi, i cili tregon realizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve për katër mujorin, duke i krahasuar me vitin e mëparshëm dhe kjo është një detyrë ligjore e cila tregon për situacionin ose si është zbatuar buxheti që është miratuar në fillim të vitit. Ashtu si u diskutua edhe nga komisioni, realizimi i të ardhurave si tetë mujor është dyzet e pesë për qind. Treqind milionësh plani, njëqind e nëntë, treqind e tetëdhjetë e katër mijë është fakti. Dyzet e pesë për qind, por duke parë, jemi munduar që të gjitha shpenzimet dhe që kemi dhe punimet që janë realizuar të bëhen edhe me të ardhurat dhe me grandin që na ka erdhur nga. ministria dhe si fakt të shpenzimeve kemi tetëqind e tetëdhjetë e nëntë milionë ose shtatëdhjetë e pesë përqind të planit të buxhetit në total, ku futen edhe grandi dhe të ardhurat. Këtu jemi përqëndruar që në realizimin e shpenzimeve të mos ngelet fond i papërdorur. Se një nga treguesit kryesorë për përfitimin e grandit të performancës është edhe realizimi i buxhetit si gjashtë mujor. Të cilin këtë vit e kishim në mënyrë të kënaqshme dhe fitojmë pikë për të përfituar grandet që do japë qeveria, qoftë grandet të huaja dhe nga grandi i vendit. Tani të gjitha këtu në një mosrealizim ngelen, sidomos këto investime, të cilat janë kontrata të lidhura në dy mijë e njëzet e pesën dhe nuk janë realizuar akoma sipas afateve të përcaktuara. Kështu që këtu mosrealizimi i të ardhurave ngelen, domethënë mosrealizimi i likuidimit të shpenzimeve për investime, të cilat nuk janë mbyllur akoma. Kurse pagat, shpenzimet operative jemi munduar që të mos nxjerrim detyrime të prapambetura nga muaji në muaj. Domethënë, të gjitha faturat dhe ato jemi munduar që t'i realizojmë brenda afateve 30 ditore dhe më tej.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë gjë tjetër këtu tek pika nëntë? E kalojmë votim. atëherë?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.

Miratohet. Me 21 vota pro pika nëntë.Faleminderit dhe kalojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës, projekt vendim për ngritjen e grupit të punës për procesin e hartimit të planit të integritetit në Bashkinë Maliq.Po

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhihalli:Në fakt, këtë grup pune ne kemi detyrim ligjor që duhet ta miratojmë nëpërmjet Këshillit Bashkiak, duke u bazuar tek ligji për të drejtën e informimit dhe transparenca, ashtu edhe strategjia sektorale kundër korrupsionit. Planin e integritetit ne e kemi aktualisht akoma aktiv deri në fund të vitit 2025. Por tashmë tre muaj para duhet të fillojmë nga puna me ngritjen e grupit të punës dhe një program pune për hartimin e planit të ri, dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë. Kështu që thjesht këtë e kalojmë në këshillë, duke u bazuar tek ligji për të drejtën e informimit dhe transparenca. Është grupi i punës i cili do të merret me hartimin e këtij plani dhe do të koordinohet gjithë puna nga ana ime.

Ornildi Demollari: Faleminderit, Po.

Yllson Ibrahimllari:E nderuar sekretare. Vërtetë, ky është një detyrim ligjor që ju imponon për ta sjellë në këshillë, por ka dhe një problematikë tjetër, sepse në grupin e punës të hartuar prej jush, ose nuk besoj që të kini dhe zëra detyrim ligjor, vetëm kaq, unë shikoj një përfaqësi shumë të paktë të Këshillit Bashkiak tek ky grup pune do të doja të përfshiheshin të paktën edhe dy kryetarët e grupeve respektive anëtarë të këtij Këshilli Bashkiak, përveç sekretarit. Sepse këshilli, domethënë në pesëmbëdhjetë veta, këshilli përfaqësohet vetëm nga sekretari, me gjithë dashamirësinë, kapacitetin e tij dhe një djalë shumë të punëtor, besoj që të kishte më shumë prezencë të këshillit në këtë hartim.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhihalli: Jo, jam shumë e dakord me këtë pjesë.

Yllson Ibrahimllari: Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, mbaheni si sugjerim edhe. S'kemi ndonjë gjë tjetër? E kalojmë votim, atëherë?
Kush është dakord? 21 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim, Nuk ka.
Miratohet. Me shtesën, patjetër kundër. kundër nuk ka. Abstenim nuk ka miratohet me shtesën e dy kryetareve të grupit, Zonja Gentiana Drabo dhe Zonja Eglantina Balli. Faleminderit, tani kalojmë tek pika tjetër, pika njëmbëdhjetë. E cili nuk është projektvendim, por është një procedurë. Që ka të bëjë me zgjedhjen e një përfaqësuesi nga Këshilli i Bashkisë Maliq për në Këshillin e Qarkut Korçë. Pas vakancës së krijuar nga një prej kolegeve tona, zonja Rudina Bregu, e cila u tërhoq. E po e kam këtë, pastaj kam auditin. Okej, dakord me mendimin tuaj.

Yllson Ibrahimllari:Që edhe të linim të lirë ekzekutivin, sepse ajo është një çështje e brendshme e këshillit dhe s'ka pse që të vonojmë ekzekutivin.

Ornildi Demollari: Shiko se, shiko se çfarë mendova. Të bëjmë propozimet e emrave. Dhe ndërkohë që pregatitet procesi, ne vazhdojmë me informacionin e auditit.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë mundem dy sekonda, jo, por edhe për të mos u bërë i bezdisur. E para punës, ky është një detyrim ligjor që na vjen nga vakanca dhe ne si grup. Do të flasë si Vera, po dal para saj, po për të diskutuar një gjë. Unë besoj që prezencën që kemi sot nuk na e lejon mundësinë e shumë hallakatjeve, ose do ta shtyjmë, ose pastaj, në qoftë se do bëjmë me emra për votim të fshehtë, do të ishte tjetër mekanizëm që nuk e di nëse do realizohet sot për numrin e prezencës. Rregullorja na imponon, që duhet përfaqësuesi në qark të marri gjashtëmbëdhjetë vota, të marri shumicë të cilësuar. Pra, duhet të jeni ju si grup gjashtëmbëdhjetë veta për të na kundërshtuar neve dhe mund të futemi në një. ngërç të përditshmes, po unë do ta thjeshtoja kryetar, duke pasur dhe dashamirësinë tënde. E para kemi detyrimin e barazisë gjinore për këtë gjë dhe normalisht zonja që është larguar, për arsye të angazhimeve të reja, i bie që përfaqësuesja që do të jetë duhet të jetë edhe ajo zonjë për të ruajtur ato raportet siç imponohet, e dyta e problemit është që në këtë këshillë ne jemi një realitet tashmë. Opozita ka përfaqësinë e një të tretës grupi, të paktën me prezencën apo pa prezencën.Sot të të gjithë anëtarëve ka një të tretën e grupit, kështu që besoj që ju keni tre në këshillin e qarkut. Duke ditur edhe vlerat tuaja demokratike në mekanizmat e vendimarrjes, unë besoj që ky përfaqësues i takon opozitës për të përfaqësuar emrin. Janë vlera reale këtu, opozita ka një të tretën e votave në këshillë, ka njëmbëdhjetë anëtarë të strukturuar prej vetë. Për të lehtësuar punën, ju konsultojeni me organizmat tuaja, me grupin tuaj, marrim kohë më vete, por besoj që ky emër i takon opozitës për ta propozuar. Ka përfaqësinë e një të tretes në qoftë se shkojmë në raportet e numrave. Ju i keni tre përfaqësues, keni zonjën Drabo, keni zotin Çami, keni zotin Idlir. Atëherë do të ketë një përfaqësues që opozita prapë të sjellë një emër dhe pastaj do të bëhet sigurisht me votim të fshehtë.

Ornildi Demollari: Jam shumë dakord me mendimin tuaj, po kjo më tepër sesa punë dakordësie apo ujdie me njëri-tjetrin. Është një proces që i nënshtrohet votimit.

Yllson Ibrahimllari: Patjetër. Po neve si këshillë mund të dalim vetëm me një kandidat në votim. Që t'ia lini opozitës, sepse i takon këta gjashtë mijë e shtatëqind vota, tetë mijë vota. Në këtë këshillë përfaqëson njerëzit në rang qarku, tregoni dhe një evolucion pozitiv të gjësë. Sepse në rang qarku, opozita nuk ka asnjë përfaqësues në këshillin e qarkut. Hajde ta bëjmë në hapin e parë. Se nuk është ndonjë gjë që do përmbysni raportet tuaja numerike. Bëni një gjë, siç keni bërë. Kini thënë që edhe në zgjedhjet e reja të administratorëve do merrni frymën e opozitës, i pamë zgjedhjet si i bëjmë. Haj të bëjmë hapin e vet, ça ju gjen juve të lëroni hapësirat për opozitën, të ketë një zë opozitar në këshillin e qarkut.

Ornildi Demollari: Jo, s'na pengon asgjë dhe nuk jemi kundër asaj, po ky është një proces që i nënshtrohet votimit, thashë.

Yllson Ibrahimllari: Po pra, dhe mund të dalim me një kanditat.

Ornildi Demollari:Të imponojmë njërin grup, t'i themi mos propozoni ju se do propozojnë këta.

Yllson Ibrahimllari: Po ju më le të propozojnë nëse ka vullnet. Më fal, sa anëtar keni te grupi sot?

Ornildi Demollari: Ja ku janë anëtarët, janë dymbëdhjetë-trembëdhjetë anëtarë.

Yllson Ibrahimllari: Po pra, duhet të marrësh gjashtëmbëdhjetë vota. Mirë është. Këtë po them, nëse ju do hyni me dymbëdhjetë anëtarë, do propozoni një nga grupi. Ne atë që do përfaqësoni ju, nuk do ta bëjmë. Doni ta shtyni mbledhjen tjetër? Shtyheni përmbledhjen tjetër, thërrisni të dy grupet. Silljani komisionit të ligjeve dhe të mandateve të gjitha kandidaturat në komision paraprak. T'i shqyrtojmë. Të themi ça rezervash kanë dhe pastaj të themi do ta bëjmë atje. Unë iu afrova një formulë. Shumë një formulë shumë domethënëse përfaqësuese nuk do jem unë, nuk do jem unë kandidati që të mos kini dhe frikën e votës kundër. Do të jetë një zonjë nga grupi i opozitës. Ju falemiderit.

Pranvera Begolli: Kryetar, për të mbështetur pjesërisht kolegun, unë jam me atë që aktualisht emrat duhet të vijnë në komisionin e ligjeve. Ti diskutojmë propozimet, ose të pjesës tonë të mazhorancës, ose të opozitës, dhe pastaj të arrijmë të gjejmë konsenusus për të dalë në.

Yllson Ibrahimllari: Nuk kemi ça verifikojmë ne, të gjithë janë të nderuar, janë anëtarë të zgjedhur dhe kur janë të zgjedhur janë legjitim. Atëherë s'më ndërpreve, po se mos të të gjejë gjë, po të jesh plotësisht me mua, se ta marrim për shkelje partie.

Pranvera Begolli: Jo, jo, të lutem. Problemi është që për mua qëndron pra të vijnë komisioni i ligjeve propozimet e të dy. Si e mendojnë? Pjesa të dy grupeve dhe mendoj se edhe kryetarët e grupeve do jenë dakord me këtë që propozovi dhe Ylli që po e miratoj edhe unë. Dhe pastaj ta lejmë për një mbledhje tjetër për të zgjedhur anëtarin e këshillit të qarkut.

Ornildi Demollari:Në qoftë se jeni, dua të gjej dakordësinë tuaj. A jemi dakord për ta shtyrë në një mbledhje tjetër për zgjedhjen? Ndërkohë që zhvillohen këto procedurat, kandidaturat shkojnë në komisionin e ligjeve. A jemi dakord ta shtyjmë për një mbledhje tjetër?

Faslli Zholi: Unë dua të shtoj një diçka, doktori e bëri shumë të qartë, jo se jemi ne të opozitës, neve bashkërisht edhe kemi thënë që të bashkëpunojmë. Dhe bashkëpunojmë, hajde shtyjmë dhe ta bëjmë me votë. Doktori ia bëri shumë, edhe e falenderoj doktorin që dha një mendim shumë të saktë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Atëherë, kjo çështje shtyhet për një mbledhje tjetër, ndërkohë që deri në Në mbledhjen e ardhshme do të shkojnë kandidaturat, do dalin kandidatura nga grupet respektive të Këshillit Bashkiak dhe do të paraqiten në Komisionin e Ligjeve. për të kaluar atë.

Yllson Ibrahimllari:I nderuar kryetar, rregullorja na lejon qoftë dhe një anëtar i vetëm i këshillit bashkiak ka të drejtën e propozimeve. Dhe nuk shmangim, të lutem zonjë. Dhe nuk shmangim zonjush, dhe nuk shmangim dot as propozimet nga seanca. Pra, mund të ketë edhe propozime gjatë ditës, pavarësisht ç'a kanë bërë grupet. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Grupi i opozitës e ka sjellë një propozim. Është zonja Eglantina Balli, propozuar nga grupi i opozitës. Të cilën do ta marrë komisioni i ligjeve tashmë, bashkë me propozimet e tjera që do dalin deri në atë kohë dhe në mbledhjen e radhës, jemi gati të bëjmë këtë procedurë. Faleminderit.Tani kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës, që është informacion mbi raportin përfundimtar të auditimit të kontrollit të lartë shtetit për periudhën 1 janar 2003-31 dhjetor 2003. Këtu është përgjegjësja e auditit, nuk e di, duke qënë se materiali ishte goxha i gjatë. Do desha të dija njëra e patë, a mund të ta shikonit deri në fund? A keni ndonjë pyetje, ndonjë sugjerim, kështu ndonjë, ndonjë koment që të mos futemi në? A ka ndonjë pyetje që ka nevojë për shpjegim?Po Petrit.

Petrit Kupe: Ne si komision e pamë këtë raport. Për kontrollin që ka ushtruar kontrolli i lartë i shtetit, ku jemi njohur edhe me rekomandimet. Me gjetjet dhe me rekomandimet, raporti është një. Raporti është goxha voluminues, sepse ka mjaft gjetje të cilat janë vlerësuar nga ana jonë. Financave dhe nga auditi i bashkisë, por ajo që bie në sy në këtë. Në këtë raport dhe në këtë informacion janë konkluzionet. Të cilat, pavarësisht se ka shumë rekomandime dhe shumë gjetje dhe shumë rekomandime. Në esencë qëndron vlerësimi total i punës së bërë nga ana e Bashkisë Maliqit. Të cilat pjesën më të madhe të këtyre rekomandimeve janë ato që kanë të bëjnë me karakter teknik. me sistemin financiar dhe më kryesorja është sepse në asnjë pikë të raportit prunimtar nuk ka dëm ekonomik. dhe është fare e arsyeshme për ata punonjës të cilët. Janë propozuar edhe ndëshkimet dhe rekomandimet për ata punonjës të shërbimit civil. Pra, raporti është shumë i rëndësishëm, por të jemi të qetë, nuk bëhet fjalë për abuzime me fonde të shpërdorime. Të fondeve të tjera, kjo është për ne më e rëndësishme nga në këtë raport dhe është pothuajse është i njëjti raport me atë të monitorimit nga KLSH-ja dhe në periudhën e vitit të kaluar. Për të cilin janë marrë edhe rekomandimet dhe sipas drejtorive përkatëse po zbatohen gjithë ato rekomandime të dhëna. Këto kishim.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë pyetje tjetër? Po.

Yllson Ibrahimllari: Pothuajse në kopipeistinn e të gjitha raporteve të KLSH, një gjë është e pa. E pandryshuar kemi probleme me menaxhimin e aseteve, me inventarizimin e tyre. Dhe në shumicën rast, nuk desha të isha insistues në pjesën e fondit të harxhuar për të destinuar, të transferuar tashmë,. për shërbimin e rezervuarit apo projektit, uji fuqizues apo uji mbledhës apo uji derivues. Problemi qëndron që neve bashkë si këshillë bashkiake kemi ngritur shqetësimin e

menaxhimit të aseteve. Unë nuk shikoj këtu dhe në të gjitha kontrollet e kontrolleve periodike që kontrolli i lartë i shtetit organizon, shikoj akoma mos stabilizimin e një inventarizimi të drejtë të të gjitha pronave në njësinë tonë të vetëqeverisjes vendore kemi ngritur problemin e dampave të pritave të rezervuar ujor. Në atë kohë u lakuam dhe thamë. Çju duhet juve, çfarë do t'ju japim juve, po t'ju japim dhe kodet, ju do t'i zbrazni ato rezervuara. Tani na vijnë vendimi që do furnizohet ai kanali, do rezervohet ai. Si mendoni, do harxhoheshin më pak lekë dhe se do ta kishim një projekt ekzistues dhe i cili do të bënte dhe do financonte, do financonte. Projekti Rehabilitues dhe një projekt i cili do ishte projekt shtesë mbi projektin bazë, apo. Kërkojmë projekte të rrugëve X ose Y rurale qoftë fshatit tim, zonës time, të gjitha zonave na thuhet që drejtoria nuk e disponon këtë projekt, nuk e ka se gjejmë. Kjo ishte ndërhyrje. Këtë e bëri bashkia me fondet e veta. Nuk kishte nevojë. U mblodh komuniteti e kërkoi komuniteti. Ka ardhur koha dhe është emergjente për këtë bashki të ketë një program. Jemi të gatshëm ta kalojmë në këshillë bashkiak një projekt, i cili do finalizojë çfarë kemi te Musendra. Çfarë kemi në inventarizim dhe ka ardhur na vijnë kullota pa masë për dhënie me qera pa skicë. Pa projekt, pa inventarizim, pa numër pasurish, bëhen tentativa të dhënies së tokave me qera. Thuhet del shtet, vej mandej e gjejmë bexhet. Hyn Syri Adel Hasan dhe tani të gjitha këto problemet e konflikteve që vijnë. Dalin nën një nevojë të vetme, teknikisht duhet zgjidhur çfarë disponon, çfarë dhe kush ka punë. Në institucione tashmë, qoftë edhe private, nga vij vetë ka filluar një frymë. Që është fryma e erës SPAK, mos kap asgjë me dorë, se po kap ndonjë gjë me dorë mund të bësh ndonjë gabim dhe mund të kesh punë. Prandaj marrim rrogën, s'bëjmë asgjë, s'ngasim asnjë njeri, nuk zgjidhim asnjë gjë. Dhe vjen KLSH, copy paste, ata copy paste letrat, n copy paste kartonët dhe vazhdojmë copy paste, copy paste dhe vëmë, katër herë njëqind metra me stafetë del imediate. Ndash dëgjoheni, ndash mos e dëgjoni të nderuar kolegë. Nuk kemi inventarizim të aseteve që ka kjo bashki. Vijnë atëherësh kur del projekti, i japim me qera. Problemi është kemi dy projektvendime që janë. Nuk ishin planifikuar, na u dërguan në rendin e ditës, i cili nuk ishte për Arditi SHPK dhe për Rozafa. Për cilën nuk ishin sjellë ato vlerat e investimit, të paktën kështu ishte argumenti i kemi lënë për mbledhjen e radhës tjetër.

Ornildi Demollari: Pra, po thua për inventarizimin, nuk kemi inventarizimin e pronave. Jo, nuk kemi inventarizimin. Thua shumë gjëra. Po shpërndahesh domethënë.

Yllson Ibrahimllari: Nuk i solle në këtë këshillë bashkiak konkretisht dy vendimet për Arditin dhe për Rozafën, se nuk të ka ardhur vlera. Raporti i monitorimit të ngre një shqetësim. Nuk ke database të dhënash të pronave që disponon bashkia. Rezervuar treqind e dyzetë e tre rezervuar që ke në njësinë administrative tënden. Nuk kanë projekt të zanafillës, nuk kanë ardhur. Të gjitha rrugët rurale të kategorisë së pestë dhe të gjashtë nuk i ke të inventarizuara projektet e tyre, nuk janë transferuar nga komunat nga Drejtoria e Rrugëve dhe Urave të Elbasanit. Nuk janë inventarizuar, nuk gjenden drejt Drejtoria e Rrugëve të Bashkisë Maliq. Jemi të saktë. Kur i sjell për qera, nuk kam një projekt. Do japim, do japim treqind milionë lekë për rezervuarin e Lëmbëthekrit. I kam rënë zyrave të shtetit. Në të gjitha vendet nuk ekziston projekti i ndërtimit të rezervuarit të Këmbëthekrit. Thonë që ia kemi transferuar bashkisë, te bashkia nuk ekziston. Ta zëmë, po marr një shembull, se ky mund të ekzistojë. Ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Atëherë kemi gjë tjetër?Afrim.

Përgjegjësi i Audit të Brendshëm; z.Afrim Beqiraj:I nderuar kryetar i këshillit, të nderuar këshilltar, më duhet të shpjegoj dy momente. Në ndryshim nga periudhat përpara që kontrolli i lartë i shtetit vinte një herë në dy vjet. Momentalisht, këto vitet e fundit po vihen vit për vit dhe janë dy auditime që bëjnë kontrolli i lartë i shtetit. Një auditim. Që quhet auditim performanca dhe auditimi tjetër është auditim financiar, pra në ndryshim nga ajo që vinte një herë në dy vjet, tani vjen për çdo vit. Atëherë, mua më duhet t'ju shpjegoj shkurtimisht disa të dhëna statistikore, me synim që në atë material të mos ketë as keqkuptime, as keqinterpretime. E sigurisht, në materialin e dhënë nga Këlëshëja janë rekomanduar gjithsej tridhjetë e një masa rekomandime nga tridhjetë e tre që kanë qenë në auditimin e fundit. Të dhëna të cilat kanë të bëjnë konkretisht nëntëmbëdhjetë masa janë me karakter organizativ nga njëzet e shtatë të dhëna më përpara. Masa shpërblim demi nuk ka dhe në auditimin e mëparshëm kanë qenë dy masa për eliminim efektesh negative të konstatuar në administrimin e fondeve dhe menaxhimi me efikasitet janë dy rekomandime, masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës janë dhjetë rekomandime. Siç shihet edhe nga numri i gjetjeve dhe rekomandimeve, të dhënat rezultojnë se nga 31 janë 19 me karakter organizativ që do të thotë 61% e tyre janë për përmirësimin e punës, organizimin e punës dhe pjesa tjetër janë për menaxhim. Vetë natyra e gjetjeve dhe rekomandimeve dhe raportimi i tyre tregon që Bashkia Maliq nuk ka qenë, nuk është dhe aktualisht nuk mbetet një institucion problematik për kontrollin e lartë të shtetit. Tani, në masat organizative që u kemi dhënë në raport, vetëm rekomandimi është citim ekzakt nga raporti përfundimtar nga shkresa e dhënave përfundimtarë të dërguar, ndërsa pjesa e argumentimit është pjesa jonë, ajo që, që unë do të, do t'ju thosha isha që, meqënëse ju e keni lexuar materialin. Do t'ju thosha që kryetari i bashkisë në vijim të punës dhe bazuar në ligjin 139, mbas ardhjes së këtyre rekomandimeve. Ka nxjerrë urdhërin numër treqind e shtatëdhjetë e katër, datë njëzet e dy të katërt të dy mijë e njëzet e pesë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga kontrolli i lartë i shtetit. Në urdhër janë marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e lënë, pra nuk ka rekomandime të pamara në konsideratë. Dhe për vërejtjet dhe për punonjësit është ngarkuar shërbimi civil që të merret rast pas rasti, duke dëgjuar edhe punonjësit për problematikat që ka secili. Në përfundim, bazuar edhe në raportin përfundimtar të auditit të hartuar nga KLSH, përmetikat e konstatuara janë të karakterit teknik dhe organizativ, për të cilët po merren masat për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Nuk ka asnjë pikë në raportin përfundimtar me dëm ekonomik, përmasa të tjera ndaj punonjësve, dhe kjo është shumë e rëndësishme. Është kërkuar nga të gjithë punonjësit dhe struktura të bashkisë të kenë parasysh punën e tyre, rekomandimet dhe përmirësimin e punës në vijm. Më duhet t'ju them që ky ballafaqim i fundit që është bërë ka ardhur si rezultat i punës së kryer nga grupi i auditimit në terren, hartimit të tyre të raportit paraprak, që është raporti projekt-raporti, bashkëpunimi me institucionin e bashkisë për kontestimet dhe observacionet e ndryshme dhe në përfundim ka ardhur raporti përfundimtar. Kështu që më duhet t'ju thashë këto dhëna dhe nuk hyra në detaje për arsye se... Kontrolli i kësaj radhe, që përfshinte vetëm vitin dy mijë e njëzetë e tre, që përfshin periudhën nga një i pari dy

mijë e njëzetë e tre deri tridhjetë e një dymbëdhjetë dy mijë e njëzetë e tre, ishte një kontroll, financiar, jo përputhshmëria, i bie që në grupet e ardhshme të jetë auditim përputhshmëria, i cili përfshin edhe dy mijë e njëzetë e tre për përputhshmëri edhe dy mijë e njëzet e katër dhe edhe e rëndësishme është këtu thanë përpara. Desha të theksoja diçka, është shumë e vërtetë që disa rekomandime janë lidhur me menaxhimin e aseteve. Më duhet t'ju shpjegoj, menaxhimi i aseteve është problem, por më duhet t'ju them që është problem në të gjitha bashkitë e Republikës së Shqipërisë. Një nga arsyet kryesore është mungesa e fondeve, për arsye se nuk, nuk janë fondet e vetë bashkisë, i bie që bashkia në gjykimin tim të mos investojë fare, që të më mbulojë gjithë këto financime që do të bëjë për këtë. Prandaj është kërkuar nga grupe të veçanta, edhe nga bashki të tjera, edhe nga ne. Është kërkuar fonde të veçanta nga qeveria lidhur me inventarizimin. Është shumë e shumë i drejtë konstatimi për menaxhimin e për inventarizimin, por ka po, por ato kanë tarifat e tyre që janë të të kushtueshme për sasitë e pronave që kanë bashkitë. Nga ish-komunat e të gjitha janë të konsiderueshme dhe fondet janë të konsiderueshme. Këshilli i Bashkisë në periudhat në vijim do të mendojë fonde të veçanta për menaxhimin e tyre.

Ornildi Demollari:E qartë faleminderit, Atëherë kemi gjë tjetër? Tek të ndryshme, po.

Faslli Zholi: Te pika diskutime të tjera, desha të ngrija një problem me gjashtë edhe përfaqësuesja e kryetarit këtu, sekretare. E kam me ju, sekretare. me ekzekutivin. Është një problem madhor dhe verifikueshëm dhe regjistrohet ta dijë, dhe kryetari e di, është ndjeni. Në fshatin Libornik, ku shkojnë ujërat e zeza të gjithë fermës dhe të Librnikut. Te një familje Dritan Kanani i kishin dalë dje mu në oborri. Prandaj duhet ta shikoni me përparësi, të vijë një komision, drejtoria e shërbimit edhe te kryetari është në dijeni, para zgjedhësve do të vijnë dy tuba, nuk e di. Se po u hap atij, se s'ka ç'bën, se do përmbytet. Pastaj do të prishet shumë çargu i madh aty. Dhe këtë desha të thosha. Dhe po mirë, po që unë po e ngrej, se më erdhën familjarët dhe lagja që po vajta e pashë atje, që ishte bërë pak shira. Po ta shihemi pra këtë sezonit me shira. Kryetari e di këtë histori. E para dhe së dyti kam kërkuar disa herë për atë rrugën për të vënë ato tubët. Më tha dhe ai G.F që kemi projektuar, kemi bërë rruga që është atje, është bërë copë-copë nga ujësjellësi që është bërë me cilësi të keqe që kur ka ardhur dhe është bërë gropa-gropa. Rruga u bë e mirë, është bërë tashi. Është thënë që do ta shikojmë, do ta riparojmë, do të marrim dhe të mbyllet edhe kanali që pjesa është e hapur, një pjesë e dytë dhe tërë plehrat janë atje. Faleminderit.

Petrit Kupe: Kam dhe unë një shqetësim, ndoshta edhe i përsëritur. Vazhdimisht kam kërkuar që të ndërhyhet në rrugët e brendshme të njësisë Liboniku, veçanërisht në fushën e Drithasit. Është thënë shpesh herë që do ndërhyjmë të sigurojmë materialin. Erdhi tetori dhe nuk është bërë asgjë. Është një fushë rreth një mijë e dyqind hektarë, ku janë gati për të nxjerrë gati tetëqind e nëntëqind hektarë prodhime misër. Por rrugët janë në gjendje shumë të këqija. Mjetet rrezikohen të përmbysen dhe dëmtohen gjatë transportit të prodhimeve. Kam parë edhe në njësitë e tjera, më vjen mirë që rrugët e njësive të Pojanit në tërësi dhe në brendësi të fushës janë sistemuar. Nuk e kuptoj pse, pse po ngelen dhe pse po zvarriten, dhe kur ndërkohë është premtuar. Nuk është e domosdoshme që të ketë material çakëll të blerë, por ka burime të sigurimit të çakllit natyral.

Bashkia e Maliqit në fshatin Shëngjergj. E cila mund t'i sistemojë ato me kosto akoma të ulët? Kërkoj që të ndërhyhet urgjentisht, sepse ky është një shqetësim i gjithë komunitetit, nuk është shqetësimi im. Ndaj ngul këmbë që të vihet në zbatim. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Kemi një tjetër, është ajo zonja aty, po urdhëro.

Qytetarja: Zotërinj dhe Zonja, ju vij përsëri për shqetësimin që kisha në mbledhjen e kalaur, dua të di deri ku është zgjidhja.

Ornildi Demollari: Po, po, e kemi, e kemi, e kemi marrë shqetësimin tuaj. Tani do të marrë kohën për t'u zgjidhur, po.

Sekretare e Përgjithshme;znj.Jonila Xhihalli: Do ja përcjellim shqetësimin tuaj z.Andi pas mbledhjes.

Ornildi Demollari: Mirë, faleminderit, ditë të mbarë në vazhdim

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI